FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 167

Tiranë – E enjte, 28 tetor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13272, datë 22.10.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	15117
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 27.10.2021	Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar.....	15117
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 619, datë 22.10.2021	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Restaurimi dhe rijetësimi i 'Banesës së Toptanasve' Muzeu Etnografik i Tiranës".....	15121
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 22.10.2021	Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimin e saj.....	15123
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 622, datë 22.10.2021	Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit.....	15127
	Korrigjim gabimi në vendimin nr. 125, datë 28.7.2021, "Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit'", të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 122, datë 3.8.2021.....	15131

DEKRET
Nr. 13272, datë 22.10.2021

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14 e 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të msëposhtëm:

1. Mirgena Gëzim Thanasi
2. Megi Llazar Zur Megede (Piti)
3. Tedi Andonaq Lamani
4. Zoica Dhimitraq Papa
5. Ergesta Luan Gjoka
6. Daniel Bledar Xhufi
7. Elisavet Bledar Xhufi
8. Angjelo Armand Brahimaj
9. Arta Astrit Memaçi
10. Kevi Agron Teli
11. Eglisard Besim Meto
12. Elona Mitrush Bita
13. Xhesi Besnik Lisi
14. Lorenc Agron Yzeiri
15. Fatbardha Miftar Kazinaki (Liçka)
16. Eglantina Vasel Sufaj (Çekaj/Cekaj)
17. Pamela Alban Sufaj
18. Sofia Alban Sufaj
19. Arbana Alban Sufaj
20. Amelia Alban Sufaj
21. Edvalda Pelivan Llanaj
22. Erjon Bardhyl Gorani
23. Herta Luan Elgit
24. Loarda Ardian Tragaj
25. Monsi Ylli Ciko
26. Marino Markelian Lazëri
27. Rozeta Mufit Zeraj
28. Lindita Pjeter Pjetri
29. Verona Admir Rrustja
30. Dhimitër (Dhimiter) Bedri Skënderi (Skenderi)
31. Albana Vojin Lešić (Musaja)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr. 31, datë 27.10.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 137/2020, "PËR BUXHETIN E VITIT 2021", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni l

Neni 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 10

Deficiti faktik i buxhetit të shtetit, i cili nuk duhet të rezultojë më tepër sesa deficiti i përcaktuar në nenin 1, të këtij ligji, mund të financohet nëpërmjet huamarrjes totale neto nga burime të brendshme dhe të huaja, prej 182 595 milionë lekësh. Brenda këtij kufiri të huamarrjes totale neto përfshihet edhe emetimi i mundshëm i një Eurobondi, me vlerë indikative prej 85 218 milionë lekësh. Ky kufi i huamarrjes totale neto mund të tejkalohet vetëm në rastet e përcaktuara në nenin 20, të këtij ligji.

Vlera indikative e financimit, nëpërmjet huamarrjes neto nga burime të huaja, është rreth 132 695 milionë lekë, ku përfshihen huamarrjet dhe ripagesat me vlera të përafërta indikative, si më poshtë vijon:

- Eurobondi 85 218 milionë lekë;
- Huamarrje afatgjata të destinuara për projekte me vlerë rreth 23 428 milionë lekë;

- Huamarrje në formën e "Mbështetjes buxhetore" nga institucione financiare ndërkombëtare, me vlerë rreth 57 419 milionë lekë;

- Ripagesa të principalit, me vlerë rreth - 34 120 milionë lekë;

- Nënhua për pushtetin vendor, me vlerë rreth 750 milionë lekë.

Vlera indikative e financimit nëpërmjet përdorimit të gjendjes së akumuluar në llogaritë e fondeve speciale në bankat e nivelit të dytë është rreth 6 000 milionë lekë.

Çdo diferencë që mund të rezultojë midis financimit total neto nga burimet e ndryshme të përmendura në këtë nen dhe deficitit faktik të buxhetit të shtetit, në rast teprice akumulohet në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit, që mbahet në Bankën e Shqipërisë ose, në rast mungese, përdoret nga gjendja e kësaj llogarie.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2021, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e kufirit të huamarrjes neto nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2, të këtij ligji.".

Neni 2

Tabela 4, që përmendet në nenin 11, zëvendësohet me tabelën 4, që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 3

Neni 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Neni 19

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të qeverisjes qendrore dhe atij të garantuar të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2021, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 201 302 milionë lekë, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë huamarrjen e brendshme dhe atë të huaj, deri në 182 595 milionë lekë;

- Për rritjen vjetore të garancive të qeverisjes qendrore në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 18 707 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik vlerësohet të arrijë në 1 425 690 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, i dhënë me hollësi, si më poshtë vijon:

- Stoku i borxhit të qeverisjes qendrore 1 357 820 milionë lekë;

- Stoku i borxhit të garantuar nga qeverisja qendrore 67 519 milionë lekë;

- Stoku i borxhit të qeverisjes vendore 350 milionë lekë.".

Neni 4

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TREGUESIT FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2021
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2021

në milion lekë (in million lek)

Nr.	EMËRTIMI	AN new date 27.10.2021	Në % të PBB	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	**489,526**	**28.2%**	**TOTAL REVENUE**
I	**Të ardhura nga ndihmat**	**20,353**	**1.2%**	**Grants**
	Nga të cilat: mbështetje buxhetore	*9,353*	*0.5%*	*from which: Budget Support*
	Nga të cilat: projekte të destinuara për investime	*11,000*	*0.6%*	
II	**Të ardhura tatimore**	**447,573**	**25.8%**	**Tax Revenue**
II.1	**Nga tatimet dhe doganat**	**320,792**	**18.5%**	**From tax offices and customs**
	Tatimi mbi vlerën e shtuar	152,061	8.8%	V.A.T
	Tatimi mbi fitimin	33,631	1.9%	Profit Tax
	Akcizat	49,400	2.8%	Excise Tax
	Tatimi mbi të ardhurat personale	41,200	2.4%	Personal Income Tax
	Taksa nacionale dhe të tjera	38,000	2.2%	National Taxes and others
	Taksa doganore	6,500	0.4%	Customs Duties
II.2	**Të ardhura nga pushteti vendor**	**25,426**	**1.5%**	**Local Taxes**
	Taksa lokale	19,778	1.1%	Local Taxes
	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	5,648	0.3%	Property Tax
II.3	**Të ardhurat nga fondet speciale**	**101,355**	**5.8%**	**Revenues from Special Funds**
	Sigurimi shoqëror	86,271	5.0%	Social Insurance
	Sigurimi shëndetësor	14,084	0.8%	Health insurance
	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,000	0.1%	Revenues for owners' in value-compensation
III.	**Të ardhura jotatimore**	**21,600**	**1.2%**	**Nontax Revenue**
	Tran.fitimi nga Banka e Shqipërisë	1,000	0.1%	Profit transfer from BOA
	Të ardhura nga institucionet buxhetore	12,000	0.7%	Income of budgetary institutions
	Dividenti	300	0.0%	Divident
	Tarifat e shërbimeve	2,800	0.2%	Services Fees
	Të tjera	5,500	0.3%	Others
	TOTALI I SHPENZIMEVE	**610,069**	**35.2%**	**TOTAL EXPENDITURE**
I	**Shpenzime korrente**	**468,771**	**27.0%**	**Current Expenditures**
1	**Personeli**	**91,139**	**5.3%**	**Personnel expenditures**
	Paga	70,845	4.1%	Wages
	Kontributi për sigurime shoqërore	11,644	0.7%	Social insurance contributions
	Fondi i veçantë i pagave	250	0.0%	Bonus fund
	Politika të reja pagash	7,600	0.4%	Contingency for new wage policies
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	800	0.0%	Higher Education from its own revenues
2	**Interesat**	**43,800**	**2.5%**	**Interest**
	Të brendshme	24,300	1.4%	Domestic
	Të huaja	15,000	0.9%	Foreign
	Kontingjencë për risqet e borxhit	4,500	0.3%	Contingency for debt related risks
3	**Shpenzime operative mirëmbajtje nga të cilat:**	**51,941**	**3.0%**	**Operational & Maintenance of which:**
	Të qeverisjes qendrore	*48,591*	*2.8%*	*Central government*
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	*800*	*0.0%*	*from revenues of Higher Education System*

	Të tjera jashtë limitit	*2,550*	*0.1%*	*from Exceptional Revenues*
4	**Subvencionet**	**1,550**	**0.1%**	**Subsidies**
5	**Shpenzime për fondet speciale**	**193,801**	**11.2%**	**Social insurance outlays**
	Sigurime shoqërore	142,265	8.2%	Social insurance
	Politika të reja pensionesh	2,400	0.1%	Contingency for new pension policies
	Bonusi i pensionistëve			Pensioners' Bonus
	Sigurime shëndetësore	46,136	2.7%	Health insurance
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	3,000	0.2%	Expenditure for owners' in value-compensation
6	**Shpenzime për buxhetin vendor**	**57,840**	**3.3%**	**Local Budget expenditure**
	Transfertat nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor	27,164	1.6%	Central Government Grant for Local Government
	Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme	*18,450*	*1.1%*	*Unconditional Fund*
	Transfertë e pakushtëzuar sektoriale (grant specifik)	*8,150*	*0.5%*	*Specific Grant*
	Transfertë për emergjencat civile	*564*	*0.0%*	
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta tatimore)	25,426	1.5%	Local Budget (Own revenues)
	Taksa të ndara	900	0.1%	Local Budget (from shared taxes revenues)
	Buxheti vendor (të ardhurat e veta jotatimore)	2,700	0.2%	Local Budget (from non-tax revenues)
	Financimi i huaj vendor	750	0.0%	Local foreign financing
	Ndërtimi i Teatrit Kombëtar (Bashkia Tiranë)	900	0.1%	
7	**Shpenzime të tjera**	**28,700**	**1.7%**	**Other expenditures**
	Pagesa e papunësisë	800	0.0%	Unemployment insurance benefits
	Ndihma ekonomike dhe paaftësia	24,700	1.4%	Social assistance and disability
	Kompensim për ish-të përndjekurit politikë	1,000	0.1%	Compensation for ex political prisoners
	Bonusi i lindjeve	2,200	0.1%	Birth Bonus
II	**Fondi rezervë**	**9,000**	**0.5%**	**Reserve fund, Contingency**
	Fondi rezervë	8,000	0.5%	Reserve Fund
	Rezervë për zgjedhjet	1,000	0.1%	Contingency for deficit financing
III	**Shpenzime kapitale**	**132,298**	**7.6%**	**Capital expenditures**
	Financimi i brendshëm	68,870	4.0%	Domestic financing
	Investime nga të ardhurat e arsimit të lartë	1,000	0.1%	From Higher Education System's own revenues
	Financimi i huaj	34,428	2.0%	Foreign financing
	nga të cilat: energjia	*2,300*	*0.1%*	*from which: Energy*
	Fondi i rindërtimit	28,000	*1.6%*	
	DEFICITI	**-120,543**	**-6.9%**	**Cash Balance**
	FINANCIMI I DEFICITIT	**120,543**	**6.9%**	**Financing (Cash)**
	të brendshëm	**-12,152**	**-0.7%**	**Domestic**
	Të ardhura nga privatizimi			Privatization receipts
	Huamarrje e brendshme	49,900	2.9%	Domestic borrowing
	Të tjera, nga të cilat:	-62,052	-3.6%	Other
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	*-68,052*		
	Ndryshimi i gjendjes së depozitës sig. shoq. dhe shend.	*6,000*		
	I huaj	**132,695**	**7.6%**	**Foreign**
	Hua afatgjatë (e marrë)	109,396	6.3%	Long-term Loan(Drawings)
	nga të cilat: Eurobond	*85,218*		
	Ndryshimi i gjendjes së arkës			Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-34,120	-2.0%	Repayments
	Mbështetje buxhetore	57,419	3.3%	Budget support
	Produkti i brendshëm bruto (PBB)	***1,735,040***	***100.0%***	***Gross Domestic Product (GDP)***

VENDIM
Nr. 619, datë 22.10.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RESTAURIMI DHE RIJETËSIMI I 'BANESËS SË TOPTANASVE' MUZEU ETNOGRAFIK I TIRANËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Restaurimi dhe rijetësimi i 'Banesës së Toptanasve' Muzeu Etnografik i Tiranës".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë banimi", me shumën e përgjithshme prej 252 314 551 (dyqind e pesëdhjetë e dy milionë e treqind e katërmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 252 314 551 (dyqind e pesëdhjetë e dy milionë e treqind e katërmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana–Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Tiranë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana-Veri, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana-Veri dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LLOGARITJET PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI
"RESTAURIMI DHE RIJETËSIMI I 'BANESËS SË TOPTANASVE' MUZEU ETNOGRAFIK I TIRANËS"

Nr.	EMËR Atësi MBIEMËR	Z. K.	NR. pas.	SIP. përgj. truall (m²)	SIP. prekur truall (m²)	Çmimi për truall (lekë/m²)	VLERA truall i prekur (lekë)	Sip. e gjurmës së objektit sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. Ndërtimi e objektit sipas kartelës (m²)	Sip. prekur objekt (m²)		ÇMIMI për objekt banimi (lekë/m²)	VLERA sip. prekur objekt, shërbimi, me situacion (lekë)	VLERA sip. prekur objekt banimi (lekë)	VLERA e përgj. truall + objekt (lekë)	KONFIRMIM ASHK TIRANË	SHËNIME
										Sip. shërbimi (m²)	Sip. banimi (m²)						
1	BP. Këllezi, Kosova, Zajmi, Hoxholli, Permeti, Podgorica, Kazazi, Pashollari, Pirgu, Llapaj, Cara, Skenderi, Stermasi, VI&VI sh.p.k.	8150	1/65	1569	1569	66969	105074361	848.00	848.00	0.00	848.00	173632.30	0.00	147240190.4	252314551	Konfirmohet me shkresat nr. prot.2622/1, datë 27.4.2020 dhe 2482/5, datë 17.8.2021, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Veri	Në seksionin "D" të kartelës së pasurisë ka shënimin "Në bazë të kontratës së nr. 683/204, datë 30.3.2009, notere Alma Poshi, kjo pasuri është me qira për 10 vjet.
VLERA TOTALE PARAPRAKE					**1569**										**252314551**		

SHËNIM.
1. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresën nr. prot. 2622/1, datë 27.4.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Veri.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 2482/5, datë 17.8.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Veri.

VENDIM
Nr. 620, datë 22.10.2021

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE, PËR VENDOSJEN E DETYRIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK NDAJ TË LICENCUARVE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, GJATË GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE PËR PËRBALLIMIN E PARANDALIMIN E SAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI I VENDIMIT

Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes e furnizimit me energji elektrike gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, si dhe për parandalimin e përballimin e saj.

II. ZBATIMI I VENDIMIT

1. Ky vendim është i zbatueshëm për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në bazë të vendimit nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", si dhe parashikon masa të vazhdueshme për përballimin e parandalimin e saj. Parashikimet e vendimit nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", janë të zbatueshme gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë vendim.

2. Rregullorja e blerjes së energjisë, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), nuk është e zbatueshme për procedurat e blerjes së energjisë, të përcaktuara në krerët IX e X, të këtij vendimi.

III. DETYRIMI I SHËRBIMIT PUBLIK GJATË GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI

Detyrimi i shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike vendoset duke marrë në konsideratë interesin publik në ushtrimin e këtij aktiviteti, për kushtet që lidhen me gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

IV. DETYRIMI I SHËRBIMIT UNIVERSAL TË FURNIZIMIT

1. Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti. Shoqëria e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të kërkesës së plotë të Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Për efekt të këtij vendimi, Furnizuesi i Shërbimit Universal dërgon te prodhuesi publik i energjisë programe mujore, javore dhe ditore për mbulimin e kërkesës me energji elektrike për klientët fundorë. Shoqëria publike e prodhimit kryen veprime shitjeje energjie dhe depozitimi / shkëmbimi vetëm pasi plotëson gjitha nevojat e furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal.

2. Në rastet kur shoqëria publike e prodhimit të energjisë elektrike nuk mund të sigurojë sasinë e nevojshme të Furnizuesit të Shërbimit Universal, e informon këtë të fundit dhe bien dakord për sasinë që do të furnizojë më pak. Në këtë rast, Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë, me anë të shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, me të njëjtin çmim që kjo energji prokurohet në treg të parregulluar.

3. Sasia e tepërt e energjisë elektrike, e krijuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga furnizimi universal, në përputhje me

parashikimet e kontratës së rregulluar ndërmjet palëve, i shitet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për mbulimin e humbjeve, sipas çmimit të shitjes së prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike nga burime hidrike, me kapacitet të instaluar deri në 15 mw, në periudhën në të cilën është kryer livrimi i energjisë, për produktin/profilin në bandë. Në këtë rast, sasia e shitur Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të tejkalojë sasinë e energjisë që është e nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet.

V. ÇMIMI I RREGULLUAR PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL

Gjatë gjendjes së emergjencës në furnizim, Furnizuesi i Shërbimit Universal është i detyruar të furnizojë klientët në treg të rregulluar të energjisë, sipas përcaktimeve të nenit 109, të ligjit të sektorit të energjisë elektrike, me çmimin e rregulluar, të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë.

VI. BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË

1. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë tregton energjinë e blerë nga energjitë e rinovueshme, për mbulimin e humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, me të njëjtin çmim me të cilin e blen këtë energji nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, deri në përfundimin e kontratave të shitblerjes së energjisë.

2. Në rast të tepricave të krijuara, ato, sipas rastit, nëse ka nevojë për furnizim të klientëve fundorë, të përdoren nga Furnizuesi i Shërbimit Universal me çmimin e blerë nga prodhuesit hidrikë me përparësi të energjisë elektrike, për përballimin e nevojave të klientëve fundorë. Në rast se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë të furnizuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal plotësohet nga shoqëria publike e prodhimit të energjisë, atëherë teprica e krijuar nga prodhuesit me përparësi shitet në treg të lirë nga furnizuesi publik në tregun e lirë.

VII. TEPRICAT E ENERGJISË SË PRODHUESIT PUBLIK TË ENERGJISË

1. Shoqëria e prodhimit publik të energjisë për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimit të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve të rregulluar kryen procedurat sipas kreut VIII, të këtij vendimi, për depozitimin e shkëmbimin e tepricave të energjisë elektrike, vetëm pasi ka plotësuar nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal. Për qëllime të këtij vendimi, tepricë e energjisë së prodhuesit publik është sasia e energjisë që mbetet pas furnizimit të plotë të nevojave të Furnizuesit Universal të Energjisë dhe të humbjeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

2. Shoqëria e prodhimit publik të energjisë ka të drejtë të bëjë optimizim financiar të kaskadës, vetëm në rastet kur nuk cenon sasitë e nevojshme të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe vetëm brenda periudhave javore ose mujore.

VIII. PROCEDURA E SHKËMBIMIT / DEPOZITIMIT TË ENERGJISË NGA PRODHUESI PUBLIK I ENERGJISË

1. Në zbatim të këtij vendimi, shoqëria publike e prodhimit të energjisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, fillon procedurat konkurruese për përzgjedhjen e subjekteve që do të bëjnë depozitimin e shkëmbimin e tepricave të energjisë elektrike. Në përfundim të kësaj procedure ndërmjet palëve lidhen marrëveshje kuadër për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

2. Nëpërmjet këtij procesi, shoqëria publike e prodhimit të energjisë depoziton/shkëmben tepricat e energjisë të destinuara për shitje në tregun e lirë, me qëllim që:

a) të maksimizojë prodhimin e energjisë elektrike nga kaskada dhe të optimizojë përdorimin e prurjeve për prodhim, për të evituar shkarkimet e ujit pa prodhuar energji elektrike dhe duke krijuar njëkohësisht rezervë energjie për periudhën e thatë të vitit;

b) të garantojë në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve kontraktore;

c) të rrisë fleksibilitetin teknik për të siguruar përmbushjen e detyrimit për shërbim publik;

ç) të minimizojë dhe/ose të parandalojë ndikimet potenciale social-mjedisore.

3. Shoqëria livron energjinë elektrike për qëllime të depozitimit dhe të shkëmbimit, në rast të krijimit të tepricave pas furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe ka siguruar rezervën hidrike, sipas rregullores së menaxhimit të plotave.

4. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë merr energjinë elektrike në periudhën e thatë të vitit, me qëllim minimizimin e kostove financiare që rrjedhin nga importi i energjisë, për mbulimin e nevojave të energjisë për konsumatorët fundorë.

5. Kriteret e kualifikimit të ofruesve në procedurën e posaçme konkurruese të zhvilluar nga shoqëria, ndër të tjera, janë, si më poshtë vijon:

a) subjekti ofertues të jetë i pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike;

b) subjekti ofertues të ofrojë garanci bankare për vlerën e energjisë elektrike të tërhequr për qëllime të shkëmbimit;

c) subjekti ofertues të ketë vlerë të kapitalit të regjistruar jo më të vogël se 30 000 000 (tridhjetë milionë) euro;

ç) subjekti ofertues nuk është në proces likuidimi/falimentimi dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore;

d) subjekti ofertues e administratori nuk janë të dënuar nga gjykata dhe as nuk ndiqen penalisht për shkelje penale, për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike apo vepra të tjera penale (pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, falsifikim, shpërdorim detyre, vjedhje, pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës dhe veprat penale në fushën e falimentit);

dh) subjekti ofertues të depozitojë pasqyrat financiare të vitit të fundit të certifikuara (pozitivisht kalueshëm dhe pa rezervë), sipas rregullave të shtetit përkatës, ku shoqëria ushtron aktivitetin;

e) shoqëria duhet të paraqesë eksperiencën e mëparshme për sigurimin e kësaj sasie energjie, edhe me kontrata afatgjata furnizimi, në masën 100% të sasisë.

6. Në rastet e tepricave të prodhimit, shoqëria publike e prodhimit të energjisë kërkon pranë palëve të kontraktuara të ofrojnë koeficientet e kthimit të energjisë elektrike që ofrohet për t'u shkëmbyer në periudhën e thatë të vitit, bazuar në kërkesën për ofertë dhe me normë kthimi të energjisë së depozituar jo më të ulët se 1 (një).

7. Çdo ofertues oferton vetëm një herë. Oferta fituese shpallen ofertat që përmbajnë koeficientin më të lartë të depozitimit dhe të shkëmbimit të energjisë.

8. Në rast se procedura e shkëmbimit rezulton e pasuksesshme, atëherë shoqëria publike e prodhimit vijon me shitjen e tepricave në treg.

9. Të ardhurat e krijuara nga shitja e tepricave akumulohen në një fond të posaçëm, i cili shërben si fond rezervë për minimizimin e riskut hidrologjik apo balancimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të shoqërisë së prodhimit për periudhat e ardhshme.

10. Këto të ardhura përdoren nga ana e shoqërisë publike të prodhimit, sipas nevojës, me miratim të Asamblesë së Aksionarit.

11. Shoqëria publike e prodhimit të energjisë bën publike gjithë dokumentacionin dhe ofertat fituese në faqen zyrtare të internetit.

IX. SIGURIMI I ENERGJISË NGA PRODHUESIT VENDAS OSE TË HUAJ TË ENERGJISË

1. Gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim, shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, në varësi të sasive të disponueshme, mund të lidhë kontrata për furnizimin me energji elektrike me prodhues vendas ose të huaj të energjisë.

2. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë organizon një procedurë të posaçme konkurruese, me afat të përshpejtuar 5-ditor, për sigurimin e sasive të energjisë me afat deri në 2 (dy) vjet. Oferta fituese të shpallen ofertat që përmbajnë uljen më të madhe për njësi nën çmimin e bursës hungareze, sipas profilit të kërkuar. Çmim tavan të jetë çmimi i bursës hungareze, sipas profilit të kërkuar. Shpallet fitues furnizuesi i energjisë që garanton sigurimin e energjisë me çmimin më të ulët.

3. Kriteret kualifikuese të ofertuesve në procedurën e posaçme konkurruese të zhvilluar nga shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, ndër të tjera, janë, si më poshtë vijon:

a) subjekti ofertues të jetë i pajisur me licencë për prodhimin e tregtimin e energjisë elektrike, të lëshuar nga ERE për ofertuesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë apo nga shtetet përkatëse për ata ofertues, të cilët janë regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë;

b) subjekti ofertues të ofrojë një sigurim bankar oferte sipas kërkesave të procedurës konkurruese, të vlefshme për një periudhë prej të paktën 5 (pesë) ditësh kalendarike nga dita e paraqitjes së ofertës;

c) subjekti ofertues të ofrojë garanci bankare për përmbushjen e detyrimeve kontraktore;

ç) subjekti ofertues të depozitojë pasqyrat financiare të vitit të fundit të certifikuara (pozitivisht kalueshëm dhe pa rezervë), sipas rregullave të shtetit përkatës, ku shoqëria ushtron aktivitetin;

d) subjekti ofertues të ketë dokumentacionin e lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës, i cili duhet të vërtetojë që:

- subjekti ofertues nuk është në proces likuidimi/falimentimi dhe kapitalet/asetet e tij nuk janë objekt i procedurave përmbarimore;

- subjekti ofertues dhe administratori nuk janë të dënuar nga gjykata dhe as nuk ndiqen penalisht për shkelje penale, për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike apo vepra të tjera penale (pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash, falsifikim, shpërdorim detyre, vjedhje, pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës dhe veprat penale në fushën e falimentit);

- subjekti ofertues ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në rastet kur ofertuesi e ka të pamundur të sigurojë dokumentacionin e lartpërmendur, për shkak të afateve të shkurtra të procedurës së posaçme konkurruese, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim nga ofertuesi, e cila vërteton të dhënat e kërkuara.

4. Në rast se nuk ka asnjë ofertues që ofron sasitë e nevojshme të energjisë edhe pas 2 (dy) thirrjeve të njëpasnjëshme, shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë ka të drejtë të hyjë në marrëveshje të drejtpërdrejtë me prodhues vendas ose të huaj, që sigurojnë këtë sasi të energjisë.

X. KONTRATA KUADËR E FURNIZIMIT TË ENERGJISË

1. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë ka të drejtë që të kryejë edhe procedurë konkurrimi për lidhjen e kontratave kuadër, për sigurimin afatgjatë të energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë dhe për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, në përputhje me përcaktimet e këtij kreu. Marrëveshja kuadër të ketë afat deri në 3 (tre) vjet.

2. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë përllogarit sasinë e nevojshme të energjisë për periudhën vjetore, sipas nevojave të Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, bazuar në skenarët e mundësive të furnizimit nga shoqëria publike e prodhimit të energjisë, si dhe e prodhuesve prioritar të energjisë së rinovueshme.

3. Mbi këtë sasi të energjisë së nevojshme, shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë të shpallë procedurën konkurruese për sasinë vjetore të energjisë nga shoqëri vendase apo të huaja. Procedura përcakton që kontrata e furnizimit të jetë për sasi të energjisë së ndryshueshme, sipas profilit me bazë orare, ditore, javore, mujore apo vjetore.

4. Kriteret kualifikuese për shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedurë konkurruese, ndër të tjera, janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë e pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike të lëshuar nga ERE për ofertuesit e regjistruar në Republikën e Shqipërisë apo nga shtetet përkatëse për ata ofertues, të cilët janë regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë;

b) të ofrojë një sigurim bankar oferte sipas kërkesave të procedurës konkurruese;

c) një angazhim që oferta e tyre të jetë e vlefshme për një periudhë prej të paktën 7 (shtatë) ditësh kalendarike nga dita e paraqitjes së ofertës;

ç) angazhimin që, në rast se ofertuesi do të përzgjidhet si ofertues fitues, ky ofertues të lëshojë një garanci bankare kontrate, në formë dhe në përmbajtje të pranueshme për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë;

d) shoqëria duhet të paraqesë eksperiencën e mëparshme për sigurimin e kësaj sasie energjie në kontrata afatgjata furnizimi në masën 100% të ofertës së bërë.

5. Çdo ofertues oferton vetëm 1 (një) herë.

6. Oferta fituese të shpallen ofertat që përmbajnë shtesën më të ulët për njësi mbi çmimin e bursës hungareze (Δ%*HUPEX), e llogaritur sipas profilit të energjisë së kërkuar nga shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë, me bazë orare, ditore, javore, mujore apo vjetore.

7. Çdo ofertues duhet të paraqesë ofertën financiare në euro për sasinë e energjisë së ofertuar.

8. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë përcakton mënyrën e bërjes së pagesave për livrimet e energjisë në njoftimin e procedurës konkurruese.

9. Shoqëria publike e furnizimit në tregun e lirë bën publike gjithë dokumentacionin dhe ofertën fituese në faqen zyrtare të internetit.

XI. TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë dhe shoqëritë KESH sh.a., "*OSHEE Group*" sh.a. dhe OST sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 622, datë 22.10.2021

PËR PROCEDURAT QË PËRDOREN PËR LIDHJEN E KONTRATAVE QË DIKTOHEN NGA INTERESA THELBËSORË TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 79 e vijuese të Kodit Civil, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrit të Mbrojtjes, ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. OBJEKTI, QËLLIMI DHE PARIMET

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i procedurës për lidhjen e kontratave të mallrave, punëve dhe/ose shërbimeve që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit. Qëllimi i këtij vendimi është përdorimi efektiv i fondeve publike dhe i çdo mjeti financiar ose kapital, i të drejtave të lidhura me to, për kryerjen e procedurave që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit.

2. Parimet kryesore, mbi bazën e të cilave hartohet ky vendim, janë:

a) parimi i barazisë, me synim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në garë;

b) parimi i sigurimit të përfitimeve maksimale gjatë procedurës së lidhjeve të kontratave për mallra, punë ose shërbime, që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit;

c) parimi i ruajtjes së sigurisë së interesave kombëtarë, duke garantuar sigurinë e informacionit.

II. FUSHA E ZBATIMIT

Ky vendim zbatohet për të gjitha procedurat e kontraktimit për mallra, punë dhe shërbime të nevojshme për kontratat që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit. Përpara fillimit të aplikimit të kësaj procedure, rast pas rasti, titullari i autoritetit kontraktor, me urdhër, miraton rrethanat e gjendjes në kushtet e interesave thelbësorë të shtetit dhe domosdoshmërinë e aplikimit të kësaj procedure.

III. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

a) "Autoritetet kontraktore", Kryeministria dhe të gjitha ministritë ose institucionet e varësisë, të deleguara me vendim të Këshillit të Ministrave.

b) "Mall", çdo gjë materiale, me vlerë ekonomike.

c) "Punim", përfundimi i ndërtimit ose i veprave civile, që përmbushin një funksion ekonomik ose teknik.

ç) "Zhvillim i pronës publike", kryerja e punëve dhe e shërbimeve për realizimin e një projekti mbi pronën publike, në përputhje me planet rregullatore të miratuara nga organet kompetente, që kanë nën administrim zonën ku ndodhet prona.

d) "Kandidat", një individ, person fizik tregtar, person juridik, ent publik ose organizatë ndërkombëtare, të ftuar për të marrë pjesë në procedurë.

dh) "Ofertues", një individ, person fizik tregtar, person juridik, ent publik ose organizatë ndërkombëtare, që paraqet një ofertë pranë autoritetit kontraktor.

e) "Procedurë konkurruese", një formë konkurrimi, në të cilën ftohen subjekte, shqyrtohen, vlerësohen dhe seleksionohen të gjitha ofertat e marra zyrtarisht për të zgjedhur ofertën më të mirë për të lidhur kontratën sipas objektit të kontraktimit.

ë) "Procedurë e drejtpërdrejtë", një procedurë, e cila përdoret vetëm në situata të nevojës ekstreme, të shkaktuara nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor ose sipas parashikimeve në këtë vendim.

f) "Dokumentet e procedurës", dokumentet që autoriteti kontraktor vë në dispozicion të kandidatëve si bazë për përgatitjen e ofertave të tyre.

g) "Fond limit", vlera monetare ose mjeti tjetër financiar ose kapital, nxjerrë nga buxheti i autoritetit kontraktor ose nën administrimin e autoritetit kontraktor, që është përcaktuar të përdoret për prokurimin për objektin konkret.

gj) "Mjet tjetër financiar ose kapital", vlerësimi fizik i aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejtave mbi to që vendosen si fond në dispozicion për realizimin e shërbimit/punës.

h) "Kontratë", çdo lloj marrëveshjeje me shkrim, e lidhur midis ofertuesit fitues dhe autoritetit kontraktor.

i) "Pezullim", ndërprerja e procedurës në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

j) "Anulim", anulimi i të gjitha veprimeve që lidhen me realizimin e një procedure në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

k) "Rivlerësim", rishikimi dhe korrigjimi i të metave të konstatuara, pas përfundimit të procesit të vlerësimit.

l) "Komisioni i Vlerësimit", komisioni që ngrihet me urdhrin e titullarit të autoritetit kontraktor dhe që ngarkohet për marrjen, shqyrtimin dhe për vlerësimin e ofertave nga kandidatët dhe ofertuesit në zbatim të këtij vendimi.

IV. PROCEDURAT PËR LIDHJEN E KONTRATËS

IV.1. Procedura e hapur

Për realizimin e një kontrate, që lidhet me interesat thelbësorë të shtetit, autoriteti kontraktor, në çdo rast, kur nuk ndodhet në kushtet e procedurave të tjera të parashikuara në këtë vendim, përdor procedurën e hapur të konkurrimit.

a) Në procedurat e hapura mund të marrin pjesë kandidatë të huaj dhe kandidatë vendës. Dokumentacioni për kandidatët e huaj do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentacioni për kandidatët vendës, nëse ka të tillë, do të jetë gjithmonë në gjuhën shqipe. Specifikimet teknike, mundësisht sa më të përshtatshme me kërkesat kombëtare, duhet të mbështeten në standardet ndërkombëtare ose në standardet që përdoren gjerësisht në tregun ndërkombëtar. Kandidatët do të lejohen të paraqesin ofertat e tyre, si dhe çdo dokument sigurimi që ata mund të paraqesin, në monedhat e tyre kombëtare ose në një monedhë që përdoret gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare, në përputhje me dokumentet e ftesës për ofertë. Kushtet e përgjithshme dhe specifike të kontratës do të jenë të tilla që përdoren gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare.

b) Njoftimi i kandidatëve, që ftohen të marrin pjesë në këtë procedurë, bëhet nëpërmjet publikimit të ftesës për ofertë në faqen zyrtare të AK-së për një afat kohor 20 ditë kalendarike.

IV.2. Procedura e drejtpërdrejtë

1. Autoriteti kontraktor zgjedh procedurën e drejtpërdrejtë në kushtet e një nevoje urgjente për mallra, për ndërtime dhe/ose shërbime, e cila është shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe koha në dispozicion për zgjidhjen e nevojës urgjente nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave të tjera, të parashikuara në këtë vendim.

2. Autoriteti kontraktor hyn në marrëdhënie dhe kërkon propozim nga kandidati/tët i/e mundshëm, të identifikuar për ofrimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve, si dhe negocion për kushtet e kontratës. Dokumentet për këtë lloj procedure duhet të përmbajnë një përshkrim të qartë për objektin e kontratës, për cilësinë, për sasinë, për kushtet ose për kohën e kërkuar për dorëzim dhe/ose kërkesa të tjera në përputhje me objektin konkret.

3. Autoriteti kontraktor zgjedh procedurën e drejtpërdrejtë në kushtet e një nevoje urgjente për përzgjedhjen e konsulentëve për përfaqësimin e interesave të shtetit shqiptar në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

IV.3. Procedura që kërkojnë edhe masa të veçanta sigurie

Në rastet kur autoriteti kontraktor do të realizojë një kontratë, e cila shoqërohet me elemente që kërkojnë masa sigurie të veçanta, për hartimin e dokumentacionit dhe administrimin do të aplikohen rregullat e parashikuara në legjislacionin për informacionin e klasifikuar. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet mbi bazë ofertash. Autoriteti kontraktor fton të marrin pjesë në konkurrim jo më pak se tre operatorë ekonomikë, të cilët njoftohen zyrtarisht për të paraqitur ofertë. Kjo procedurë prokurimi nuk zhvillohet me mjete elektronike.

V. KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor urdhërohet ngritja e Komisionit të Vlerësimit.

2. Komisioni i Vlerësimit kryesohet nga nëpunësi autorizues dhe ka në përbërje të tij nëpunës të nivelit drejtues të lartë dhe të mesëm të autoritetit kontraktor. Në rastet e prokurimit, që lidhen me zhvillimin e një prone publike, që është në administrim të organeve të varësisë, Komisioni i Vlerësimit duhet të ketë në përbërje të tij, përveç sa është përcaktuar në fjalinë e parë të kësaj pike, titullarin e organit të varësisë dhe nëpunës të këtij organi. Në rastin e mungesës së personelit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë

ekspertë të jashtëm, si anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të ofertave.

3. Komisioni i Vlerësimit ka këto detyra specifike:

a) të përcaktojë procedurën që duhet ndjekur për realizimin e kontratës dhe ta paraqesë për miratim te titullari i autoritetit kontraktor;

b) mbas miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor të procedurës, në varësi të procedurës së përzgjedhur, të hartojë dokumentacionin "Ftesë për ofertë", për propozim kandidatëve të mundshëm, me qëllim përgatitjen prej tyre të ofertave. Dokumentacioni i ftesës për ofertë të hartohet në përputhje me rregullat e informacionit të klasifikuar në rastet kur është e aplikueshme. Për përgatitjen e dokumenteve të tenderit në rastet e zhvillimit të procedurave për pasuri që ndodhen në territorin e një shteti tjetër, Komisioni i Vlerësimit mund të asistohet për marrjen e ekspertizave të specializuara nga një konsulent ligjor i vendit ku ndodhet pasuria. Përzgjedhja e konsulentit bëhet nga Komisioni i Vlerësimit me procedurë të drejtpërdrejtë dhe miratohet nga titullari i autoritetit kontraktor përkatës;

c) në varësi të procedurës, të bëjë shpalljen e njoftimit për kryerjen e procedurës në faqen e internetit të autoritetit kontraktor ose të njoftojë ofertuesin/sit e mundshëm, duke iu paraqitur ftesën për ofertë;

ç) të shqyrtojë dhe të vlerësojë ofertat e paraqitura nga kandidatët, sipas rregullave që do të përshkruhen në vijim të këtij vendimi;

d) të shpallë kandidatin fitues, të negociojë dhe të ndjekë procedurat deri në lidhjen e kontratës;

dh) për zbatimin e shkronjës "d", mbas shpalljes së kandidatit fitues, Komisioni i Vlerësimit të hartojë projektvendimin për miratimin e kontratës me kandidatin e shpallur fitues. Në rast se kontrata nuk miratohet nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura konsiderohet e anuluar.

VI. VLERËSIMI I OFERTAVE

1. Ofertat dhe dokumentacioni përkatës, i përcaktuar në ftesën për ofertë, paraqiten nga secili kandidat me shkrim, në zarf të mbyllur, në vendin, datën orën e përcaktuar në ftesën për ofertë, dorazi nga përfaqësuesi i kandidatit ofertues.

2. Hapja e ofertave bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave në prani të të gjithë përfaqësuesve të kandidatëve ofertues në vendin, orën dhe datën e caktuar në dokumentet e ftesës për ofertë.

3. Nëse një apo më shumë kandidatë, pas konfirmimit të marrjes dijeni nuk paraqiten në vendin, orën dhe datën e caktuar në ftesën për ofertë, mosparaqitja e tij/tyre nuk pengon zhvillimin e procedurës së hapjes dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura. Komisioni i Vlerësimit të ofertave e evidenton në procesverbalin e mbledhjes këtë fakt.

4. Në rast të paraqitjes të vetëm një oferte, Komisioni i Vlerësimit vijon procedurën e vlerësimit të saj.

5. Mbas hapjes së ofertave në prani të përfaqësuesve të kandidatëve ofertues Komisioni i Vlerësimit administron ofertat e paraqitura nga kandidatët ofertues dhe tërhiqet për vlerësimin e tyre.

6. Komisioni i Vlerësimit, mbas administrimit të ofertave, cakton një afat për shpalljen e ofertës fituese, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 20 (njëzet) ditë kalendarike nga data e hapjes së ofertës. Afati i shpalljes së ofertës fituese, data, vendi dhe ora e shpalljes u njoftohen me shkrim kandidatëve ofertues që kanë paraqitur ofertë.

7. Komisioni i Vlerësimit vlerëson dhe i krahason ofertat (kuotimet) e vlefshme, në përputhje me kriteret e vlerësimit, të përcaktuara në dokumentet e ftesës për ofertë, me qëllim që të përcaktojë ofertën ose kuotimin fitues. Vlerësimi bëhet mbi sistem pikësh, të cilat përcaktohen në ftesën për ofertë. Oferta ose kuotimi fitues do të jetë ajo që, në bazë të kritereve të vlerësimit, merr më shumë pikë. Komisioni, në vendimin përkatës për vlerësimin dhe për klasifikimin e ofertave, mbështetur në pikët e marra, i rendit në klasifikim ofertat (kuotimet) dhe ofertuesit e tyre respektivë, duke filluar nga oferta (kuotimi) fituese dhe duke vazhduar me radhë me të gjitha ofertat (kuotimet) e tjera, përfshirë dhe ato që nuk janë kualifikuar. Ky vendim nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe në të mund të shprehen votat kundër, qëndrimet, mendimet, pretendimet dhe argumentet për to të anëtarëve, në rast se ka të tilla. Në rast se, pas vlerësimit të ofertave teknike-ekonomike, rezultojnë oferta pretendente të barabarta, oferta fituese do të përcaktohet nga shorti i hedhur ndërmjet ofertuesve që kanë paraqitur këto oferta të barabarta. Në përfundim të kësaj faze, kryetari i Komisionit të Vlerësimit ka për

detyrë të paraqesë te titullari i autoritetit kontraktor një informacion përmbledhës për të gjithë procedurën e kryer, si dhe argumentimin për përzgjedhjen e ofertës fituese.

8. Procedura e vlerësimit anulohet dhe përsëritet (nëse është rasti), në rastet kur:

a) nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm i anëtarëve të komisionit (jo më pak se pesë vetë);

b) asnjë kuotim ose ofertë e sjellë nuk plotëson kërkesat dhe/ose specifikimet teknike të kërkuara.

9. Procedura pezullohet nga titullari i autoritetit kontraktor në rastin e paraqitjes së një ankese nga ndonjëri prej kandidatëve ose ofertuesve. Në këtë rast, titullari ngre një komision për shqyrtimin e ankesës, i cili duhet të dalë me vendim brenda 5 (pesë) ditëve.

10. Në rastet kur nga komisioni i shqyrtimit të ankesave konstatohen parregullsi, të meta, mangësi ose shkelje në procedurë, titullari ia kthen Komisionit të Vlerësimit për rivlerësim.

11. Kur kandidati do të realizojë një pjesë të objektit me nënsipërmarrje, kjo mund të pranohet nga Komisioni i Vlerësimit me kusht që të jetë lidhur një kontratë e noterizuar (përpara datës së hapjes ose pranimit të ofertave ose kuotimeve) ndërmjet kandidatit dhe nënsipërmarrësit, ku të jetë parashikuar ajo pjesë e objektit që do të realizohet nga nënsipërmarrësi.

12. Kryetari i Komisionit të Vlerësimit i paraqet titullarit informacionin përmbledhës. Ky informacion shoqërohet me raportin përmbledhës, si dhe me vendimin e komisionit për klasifikimin e ofertave dhe për përzgjedhjen e ofertës fituese. Titullari i autoritetit kontraktor, në bazë të dokumentacionit të lartpërmendur, gjykon nëse është e nevojshme të kërkohet për shqyrtim i gjithë dokumentacioni i procedurës. Nëse gjykohet i rregullt, brenda afatit prej 2 (dy) ditësh nga marrja e vendimit të komisionit, titullari i autoritetit kontraktor miraton ofertën fituese.

13. Mbas miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor, oferta e shpallur fituese u njoftohet kandidatëve ofertues me shkrim, të cilëve u njoftohet e drejta për ankim ndaj vendimit të Komisionit të Vlerësimit. Afati i ankimit është 5 (pesë) ditë nga data e njoftimit.

14. Komisioni i Vlerësimit shqyrton ankesat brenda afatit 5-ditor nga data e paraqitjes së tyre dhe njofton ministrin përgjegjës për rezultatet e vlerësimit të ankimit.

15. Mbas përfundimit të procedurës së ankimit, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron Komisionin e Vlerësimit për negocimin e kontratës me kandidatin fitues.

16. Pas negocimit, kontrata së bashku me relacionin përkatës i dërgohet titullarit të autoritetit kontraktor për miratim. Në rast se ofertuesi fitues nuk pranon të lidhë kontratë dhe tërhiqet, kjo dokumentohet dhe shpallet fituese oferta e klasifikuar e dyta. Në rast se edhe ofertuesi i klasifikuar i dyti nuk pranon të lidhë kontratë, atëherë procedura anulohet.

17. Kontrata me kandidatin e shpallur fitues nënshkruhet nga titullari i autoritetit kontraktor përgjegjës ose i deleguari prej tij.

VII. MIRATIMI I KONTRATËS

1. Kontratat, që diktohen nga interesat thelbësorë të shtetit pas nënshkrimit të tyre, do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Kontrata do të hyjë në fuqi pas këtij miratimi. Ky kusht do të jetë i specifikuar edhe në kontratën e nënshkruar ndërmjet palëve dhe në dokumentet e procedurës konkurruese. Përjashtimisht, kontratat e posaçme (MEA) të lidhura sipas përcaktimeve të kreut VIII, të këtij vendimi, hyjnë në fuqi me nënshkrimin nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe prodhuesi ose mbajtësi i autorizimit të tregtimit të barit, sipas rastit, dhe nuk i nënshtrohen miratimit nga Këshilli i Ministrave.

2. Në rastet kur kontrata nuk miratohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga Këshilli i Ministrave, atëherë procedura do të quhet e anuluar.

VIII. KONTRATA TË POSAÇME (MEA)

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë mund të lidhë kontrata të posaçme (*Managed Entry Agreements ose MEA*), me prodhues të një bari, kur prodhuesi është edhe Mbajtës i Autorizimit të Tregtimit të barit, ose me Mbajtësin e Autorizimit të Tregtimit të barit vetëm, në rastin kur prodhuesi nuk është Mbajtës i Autorizimit të Tregtimit për atë bar, në këto raste të veçanta:

a) kur bari mund të sigurohet vetëm nga një prodhues/mbajtës i autorizimit të tregtimit, i cili zotëron të drejtat ekskluzive mbi atë bar;

b) kur përdorimi i teknologjisë së barit mund të rrisë efikasitetin e trajtimit të pacientëve në spitalet publike dhe kur bari është alternativë e vetme për një sëmundje ose indikacion të caktuar;

c) për sasi të garantuara bari, me çmim më të ulët se ai i deklaruar, miratuar nga ministria.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE PËR PROCEDURAT QË LIDHEN ME EPIDEMINË E SHKAKTUAR NGA INFEKSIONI COVID-19

1. Për procedurat e lidhjes së kontratave, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, dispozitat e këtij vendimi zbatohen me përjashtimet e mëposhtme:

a) Me termin "autoritete kontraktore", të përkufizuar në shkronjën "a", të kreut III, të këtij vendimi, kuptohen të gjitha ministritë dhe institucionet e varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të deleguara me urdhër të ministrit përkatës.

b) Për procedurën e drejtpërdrejtë, të përcaktuar në nënndarjen IV.1, të kreut IV, të këtij vendimi, nuk zbatohen dispozitat e parashikuara për procedurën e ankimit.

c) Komisioni i Vlerësimit, i përcaktuar në pikën 2, të kreut V, të këtij vendimi, kryesohet nga një nëpunës i nivelit të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe ka në përbërje të tij nëpunës me arsim të lartë.

2. Vendimi nr. 203, datë 26.2.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurat që përdoren për lidhjen e kontratave që diktohen nga interesa thelbësorë të shtetit", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin nr. 125, datë 28.7.2021, "Për miratimin e rregullores 'Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit'", të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare botuar në Fletoren Zyrtare nr. 122, datë 3.8.2021, bëhet korrigjimi i gabimit në nenin 19, pika 2, germa "a", dhe në nenin 20, pika 2, germa "a", ku vendosen thyesat që përcaktojnë pjesën përkatëse të vlerës së dëmit që përfiton pala e dëmtuar si me poshtë:

Neni 19 ishte:

Neni 19
Dëmi moral

1. Dëmi moral është shfaqje e brendshme e turbullimit të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore individuale dhe e familjarëve të të dëmtuarit.

2. Përllogaritja e dëmit moral me pasojë paaftësinë e përhershme, kryhet si më poshtë:

a) Vlera e dëmit moral për çdo person të dëmtuar, me pasojë paaftësi të përhershme për punë, përllogaritet në varësi të shkallës së paaftësisë si vijon:

- deri në 30% paaftësi, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 30% deri në 45%, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 45% deri në 60%, pala e dëmtuar do të përfitojë sa vlera e dëmit biologjik;
- mbi 60% deri në 75%, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 75% pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik.

Neni 19 bëhet:

Neni 19
Dëmi moral

1. Dëmi moral është shfaqje e brendshme e turbullimit të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore individuale dhe e familjarëve të të dëmtuarit.

2. Përllogaritja e dëmit moral me pasojë paaftësinë e përhershme, kryhet si më poshtë:

a) Vlera e dëmit moral për çdo person të dëmtuar, me pasojë paaftësi të përhershme për punë, përllogaritet në varësi të shkallës së paaftësisë si vijon:

- deri në 30% paaftësi, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{3}{4}$ e dëmit biologjik;
- mbi 30% deri në 45%, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{4}{5}$ e dëmit biologjik;
- mbi 45% deri në 60%, pala e dëmtuar do të përfitojë sa vlera e dëmit biologjik;
- mbi 60% deri në 75%, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{5}{4}$ e dëmit biologjik;
- mbi 75% pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{3}{2}$ e dëmit biologjik.

Neni 20 ishte:

Neni 20
Dëmi ekzistencial

1. Dëmi ekzistencial është cenimi i të drejtave të personalitetit të njeriut, duke dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen e të dëmtuarit si njeri ose të familjarëve të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, si në cilësinë e jetës, ashtu dhe në marrëdhëniet personale dhe familjare.

2. Përllogaritja e dëmit ekzistencial me pasojë paaftësinë e përhershme, kryhet si më poshtë:

a) Vlera e dëmit ekzistencial për çdo person të dëmtuar, me pasojë paaftësi të përhershme për punë, përllogaritet në varësi të shkallës së paaftësisë, si vijon:

- deri në 30% paaftësi, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 30% deri në 45%, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 45% deri në 60%, pala e dëmtuar do të përfitojë sa vlera e dëmit biologjik;
- nga 60% deri në 75%, pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik;
- mbi 75% pala e dëmtuar do të përfitojë e dëmit biologjik.

Neni 20 bëhet:

Neni 20
Dëmi ekzistencial

1. Dëmi ekzistencial është cenimi i të drejtave të personalitetit të njeriut, duke dëmtuar në mënyrë të përhershme shprehjen e të dëmtuarit si njeri ose të familjarëve të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, si në cilësinë e jetës, ashtu dhe në marrëdhëniet personale dhe familjare.

2. Përllogaritja e dëmit ekzistencial, me pasojë paaftësinë e përhershme, kryhet si më poshtë:

a) Vlera e dëmit ekzistencial për çdo person të dëmtuar, me pasojë paaftësi të përhershme për punë, përllogaritet në varësi të shkallës së paaftësisë, si vijon:

- deri në 30% paaftësi, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{3}{4}$ e dëmit biologjik;
- mbi 30% deri në 45%, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{4}{5}$ e dëmit biologjik;
- mbi 45% deri në 60%, pala e dëmtuar do të përfitojë sa vlera e dëmit biologjik;
- nga 60% deri në 75%, pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{5}{4}$ e dëmit biologjik;
- mbi 75% pala e dëmtuar do të përfitojë $\frac{3}{2}$ e dëmit biologjik.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 167
Datë: 2021/10/28 15:23:40
2fb240fc-d952-4c3b-847a-a55455fd4766

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë